



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-II-15-0034

F.G.

Paditësit

S1.G.

S2.G.

A.G.

S3.G., të gjithë nga Prizren.

Kundër:

E paditura/*Ankuesja*

KBI , N.SH. Prizren

Administruar nga **Agjencioni Kosovar i Privtizimit**, Rr. Agim Ramadani 23.
Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Hajrie Shala gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankueses të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Priren, C.nr. 757/2007 të datës 21/04/2010, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12 shtator 2019 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.

2. Anulohet, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, Prizren, C. nr. 757/07 i datës 21/04/2010.

3. Lënda, dërgohet për shqyrtim në shkallë të parë të DHPGJS-së.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datën 16/11/2007, paditësit parashtruan një padi në Gjykatën Komunale në Prizren nëpërmjet së cilës kërkuar dorëzimin e patundshmërisë, ngastrave kadastrale nr. 9042/1, 9042/2 dhe 9042/4 me bonitet të njëjtë në vendin e quajtur "B" në sipërfaqe prej 9.78 ari ose sipërfaqe dhe bonitet të njëjtë në një vend tjetër nëse dorëzimi i patundshmërisë së kërkuar është i pa mundur si dhe regjistrimin në Librat kadastral.

Paditësit pohuan se babai i tyre tani i ndjerë ishte pronar i patundshmërisë, ngastrës kadastrale, nr. 9042 , Lista poseduese nr. 130 në sipërfaqe prej 0.22,10 ha. e cila patundshmëri me Kontratën e shitblerjes, Leg. Nr. 1838/64 të datës 24/11/1964 të vërtetuar në Gjykatën Komunale, Prizren është transferuar tek e paditura KBI Prizren.

Sipas paditësve Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykim, C.nr. 717/95 të datës 19/09/1996 kishte anuluar Kontratën e shitblerjes, Leg. Nr. 1838/64 të datës 24/11/1964 dhe kishte vendosur kthimin e një pjese të patundshmërisë, ngastrës kadastrale, 9042/3 në sipërfaqe prej 12.32 ari nga lista poseduese nr. 10377, Komuna kadastrale, Prizren, paditësve.

Provë, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, Prizren P.br. 717/95 i datës 19/09/1996.

Me 21/04/2010, Gjykata Komunale në Prizren nxori Aktgjykimin C. nr. 757/07 me të cilin aprovet kërkesa e paditësve F.C. e lindur G , S G, S G dhe S3.G. si të bazuar dhe obligoi të paditurën KBI Prizren NSh. që paditësve si trashëgimtarë të njoh të drejtën e pronësisë në patundshmërinë, ngastra kadastrale nr. 9042/3, vendi i quajtur B, në sipërfaqe prej 9.78 ari në vend të kësaj si kompensimi të jap në shfrytëzim dhe posedim të lirë pjesën e ngastrës

kadastrale nr. 656/1, vendi i quajtur "PO" në sipërfaqe prej 9,78 ari, lista poseduese nr. 249 ,zyra kadastrale, D. në kufijtë, nga veriu prej 50 m. nga jugu prej 49,96 m. nga lindja 19.67 m. dhe nga perëndimi prej 19.66 m. si dhe të lejojë regjistrimin e paditësve si bashkëpronarë në pjesët ideale dhe atë nga 1/5 për secilin paditës në librat kadastral.

Aktgjykimi nga AKP-ja është pranuar më 02/06/2010.

Më 14/06/2010,e paditura AKP-ja, (më tutje Ankuesi) ka parashtruar ankesë në DHPGHS, kundër Aktgjykimit, C. Nr.757/2007 të datës 08/06/2010 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Lënda evidentohet me nr. SR-11-0204. Me Aktvendimin e datës 23/05/2012 lënda me nr. C.nr.757/07 në gjykatën komunale, Prizren dhe nr. AC.nr.343/2010 në Gjykatën e Qarkut Prizren, tërhiqet për t'u gjykuar në DHPGJS. Lënda evidentohet si C-III-120890. Më 12/05/2015 nëpërmjet urdhrin të brendshëm lënda dërgohet për gjykim në Kolegjin e Apelit dhe evidentohet me nr. AC-II-15-0034.

Ankuesja AKP-ja, pretendon se Gjykata e Shkallës së I-rë Aktgjykimin e ankimuar e ka nxjerrë në kundërshtim me prezumimet procedurale pasi që paditësit nuk kanë prezantuar dëshmi se janë trashëgimtarë të paraardhësit juridik babait të tyre, atyre u mungon legjitimiteti aktiv për të cilën gjykatat kujdeset ex officio. Gjithashtu Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë do duhej të ishte kujdesur edhe për kompetencën e saj lëndore. Sipas nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2008/4 për çështjet e natyrës së tillë kompetente është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

Më tutje AKP-ja pohoi se aktgjykimi në fjalë ka karakter deklarativ dhe asesi nuk ka konstituar një të drejtë, dhe se paditësve nuk mund të ju epet një pronë tjetër pa u vërtetuar paraprakisht e drejta e pronësisë.

Andaj AKP-ja kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe padia të refuzohet si e pa bazuar.

Ankesa e AKP-së i është dorëzuar paditësve më 28/06/2018. Deri më tani nuk është parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor

Kolegji i Apelit vendosi që të mos mbajë pjesën gojore të procedurës, në bazë të nenit 69 paragrafi 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

AKP-ja, ankesën e vetë e bazon në arsyet se Gjykata Komunale, Prizren ka gjykuar në inkompetencë, sepse kompetente për këtë çështje ishte Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kolegji i Apelit konsideron se ankesa e AKP-së është parashtruar brenda kornizave kohore ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta, andaj ankesa në rastin konkret kontestimor konsiderohet e pranueshme.

Në bazë të nenit 5 paragrafi 1.11, të Ligjit të Dhomës së Posaçme, Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive në rastin konkret, dhe është e obliguar që të vlerësoj ligjshmërinë e një aktgjykim apo aktvendimi të lëshuar nga një gjykatë tjetër në Kosovë, lidhur me kërkesat apo lëndët e përcaktuara me këtë paragraf. Ndërkaq, në bazë të paragrafit 4 paragrafi 2 i Rregullores së UNMIK-ut, që ishte e zbatueshme në kohën e nxjerrjes së aktgjykimeve kontestuese, asnjë gjykatë në Kosovë nuk mund të ushtroj juridiksion për paditë apo të zgjidh rastet që përfshinë lëndët e përshkruara në nenin 5.1 (që ka të bëjë me kompetencën primare), përveçse nëse një padi e tillë i është referuar asaj gjykate në pajtim me këtë nen.

Kolegji i Apelit konstaton se kjo padi nuk ishte e referuar nga Dhoma e Posaçme asnjëherë, dhe rrjedhimisht kjo gjykatë kishte vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë në zbatim në Dhomën e Posaçme, dhe në kundërshtim me nenin 182, paragrafi 2, pika (f) e LPK-së.

Kjo gjykatë ka qenë e obliguar që në bazë të nenit 17, paragrafi 1 i LPK-së, ex officio të trajtoj nëse është kompetente për të gjykuar rastin e parashtruar para saj ose jo. Në këtë mënyrë, në zbatimin e procedurave gjatë vendimmarrjes, kjo gjykatë ka marrë Aktgjykimin e kundërshtuar, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Për arsyet e lartpërmendura, Kolegji i Apelit, nuk mund të vërtetoj asnjë vendim me shkelje të tilla procedurale, andaj është e obliguar që t'i (anuloj) shpallë, Aktgjykimin e kundërshtuara pa efekt juridik.

Në bazë të nenit 5, paragrafi 4 i LDHP-së, as Dhoma e Posaçme e as kolegjet apo gjyqtarët e saj, nuk do të kenë asnjë autoritet, për t'i referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë, apo rast specifik që është kompetencë primare e tyre, tek gjykatat e tjera në Kosovë.

Për këtë arsye, duke mos paragjykuar epilogun përfundimtar të kësaj padie, Kolegji i Apelit lëndën e dërgon në gjykim në Kolegji përkatës të Specializuar të DHPGJS-së.

Andaj konform nenit 9.10 të LDHPGJS-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen tasat gjyqësore për procedurën ankimore, sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive për lëndët në pritje.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 12 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues i Kolegjit të Apelit _____

URDHËR PËR REGJISTRIN

Luteni ta dërgoni këtë Aktvendim:

- Palët
- Gjyqtari Kryesues në Gjykatës Themelore në Prizren, numri i lëndës C.nr.757/2007.

Gjyqtari kryesues , Ilmi Bajrami _____